



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E SHËRBIMEVE FUNERALE
NJËSIA E PROKURIMIT**

Data: 29. 04. 2026

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës – Mallra

Objekti i Procedurës: “Blerje herbicide pesticide”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): Pesticide-24451000-0. Herbicide - 24453000-4.

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,424,000 (një milion e katërqind e njëzet e katër mijë) lekë pa TVSH. Njësia e Prokurimit për procedurën në fjalë vendos që lloji i procedurës së prokurimit të jetë: **Procedurë e Hapur e thjeshtuar, mallra.**

Arsyet e përdorimit të procedurës - “ E hapur e thjeshtuar”, Mallra, është sepse vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar.

Kriteret e përgjithshme të pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 2 pika “c”, nenit 78 pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Funerale, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
 - c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
 - ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
 - d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
 - dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
 - e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
 - f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
 - g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
 - gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
 - h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
 - i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
 - j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
 - k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.
- Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkëpunim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Argumentim: Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

II. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentim: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”(i ndryshuar) si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik (i ndryshuar): citojmë Neni 83 i LPP (i ndryshuar) “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP (i ndryshuar) “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklarimit me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten

nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, neni 77, pika 1/a dhe 2; Nenin 26 pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 9 të DST-së.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (**2023, 2024, 2025**), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit të përllogaritur**. Kriteri *konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43 pika 2 dhe neni 55 pika 4 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar **në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit të përllogaritur**, është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*
a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.

b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme.

2.2.2 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për këstet e maturuara për vitin **2026**, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit 9632, datë 30.10.2006 ”Per Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, për të gjitha vëndet ku operatori ekonomik ushtron aktivitet sipas Regjistrimit në Qëndrën Kombëtare të Biznesit, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore të parashikuara në ligjin 9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit sipas shtojcës 9 ne DST, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentim: Kërkesa e mesepërme është percaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43 pika 6, nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, nënenin 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB”, i ndryshuar.

Për të vërtetuar që subjekti nuk është debitor në pagimin e taksave vendore të Qeverisjes Vendore dhe është subjekt që garanton qëndrueshmëri dhe është korrekt me detyrimet ligjore që ai ka. Janë kërkuar kështu e maturuara për vitin **2026**, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar për të siguruar konkurrencë të lirë për gjithë OE fizike apo juridike.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për kështu e maturuara për vitin **2026**, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari Biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në një vlerë jo më të vogël se 20 % e fondit limit.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Operatorët ekonomikë si dëshmi për përvojën e mëparshme duhet të paraqesin vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe

fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara..

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe neni 55 pika 4/b dhe neni 40, pika 4 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin deklaratë që furnizimi, ngarkim-shkarkimi, transporti, do të bëhet me mjetet, puntoret dhe shpenzimet e operatorit ekonomik fitues sipas grafikut të lëvrimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe neni 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që marrin përsipër realizimin e objektit të kontratës, nëpërmjet furnizimit, ngarkim-shkarkimit, transportit me mjetet, puntoret dhe shpenzimet e tyre, sipas grafikut të lëvrimit të vendosur nga autoriteti kontraktor.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me **Licencën për nënkategorinë II. 5. A.**, me të gjitha nënkategoritë e saj.

Argumentim: Në zbatim Ligjit me nr. 105/2016 “Për mbrojtjen e bimëve”, i ndryshuar, neni 20, Vendimit Nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

Kërkesa e mësipërme gjithashtu është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, “.Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose...”, si dhe Ligjin nr. 10081, datë 23.02.2009 ”Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Ky kriter është një garanci për autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë pjesëmarrës e ushtrojnë aktivitetin e tyre konform legjislacionit në fuqi.

4. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikatë të vlefshme të cilësisë, ku të përfshijë objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

- S SH EN ISO 9001: 2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;
- S SH EN ISO 14001: 2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente/ të barazvlefshme;
- S SH EN ISO 45001: 2018 mbi “Sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë” ose ekuivalente / të barazvlefshme;

Çertifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë

Çertifikatat e kërkuara më sipër, janë vlerësuar se lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës, dhe konkretisht:

- Çertifikata S SH EN ISO 9001: 2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme, është një provë dhe garanci se operatori ekonomik ofertues ka një system të menaxhimit të cilësisë, nëpërmjet së cilës demonstron aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte, që plotësojnë standartet më të larta të cilësisë.

- Çertifikata S SH EN ISO 14001: 2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente/ të barazvlefshme, është vendosur si kriter duke marrë në konsideratë faktin që: Standarti ISO 14001 Sistemi i Menaxhimit Mjedisor është një sistem sistematik dhe i orientuar drejt procesit të menaxhimit të cilësisë për të kontrolluar impaktet e rëndësishme të aktiviteteve të biznesit në mjedis, dhe në rastin konkret duke qenë se objekt i prokurimit janë herbicide dhe pesticide, si dhe duke vlerësuar faktin që këto mallra do të përdoren për spërkatje në ambjente publike, paisja me këtë standart është e rëndësishme sepse siguron që këto mallra do të prokurohen nga OE, që i plotësojnë kërkesat minimale të ndikimit në mjedis.

- Çertifikata S SH EN ISO 45001: 2018 mbi “Sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë” ose ekuivalente / të barazvlefshme është një çertifikatë, e cila ofron një kuadër për menaxhimin efikas të shëndetit dhe sigurisë në punë, përfshirë të gjitha aspektet e menaxhimit të riskut dhe të përputhshmërisë ligjore nga operatorët ekonomikë, të cilët do të ekzekutojnë kontratën që po prokurohet. Një operator ekonomik i certifikuar sipas këtij standarti është në gjendje të:

Krijojë kushtet më të mira të punës në të gjithë organizatën e tij;

Identifikojë kërcënimet dhe vendos kontrollin për menaxhimin e tyre;

Redukton aksidentet dhe sëmundjet në vendin e punës duke minimizuar kostot dhe kohën joproductive;

Përfshin dhe motivon stafin me kushte me të mira dhe më të sigurta pune;

Dëshmon përputhshmëri ndaj klientëve dhe furnitorëve.

Për të gjitha sa më sipër, kjo çertifikatë është kërkuar me qëllim garancinë e AK se ofertuesi ka potencialin e duhur për ushtrimin e veprimtarisë së tij, sa i takon të gjitha aspekteve të menaxhimit të riskut dhe të përputhshmërisë ligjore, dhe rrjedhimisht garanton AK mbi vazhdimësinë e marrëveshjes kuadër dhe zbatimin e kontratave që do të lidhen në kuadër të saj.

I. SPECIFIKIME TEKNIKE PËR

Këto mallra bëjnë pjesë në listën e PMB-ve të prillit të vitit 2026 të regjistruara për t'u importuar dhe tregtuar në Republikën e Shqipërisë.

-HERBICID ME LËNDË VEPRUSE GLYPHOSATE

Lënda vepruese e herbicidit të ketë 36% glyphosate. Herbicid sistematik, jo selektiv që lufton barërat e këqija një dhe shumë vjeçare, shkurret etj. Herbicidi të jetë efektiv në vrasjen e një shumëllojshmërie të gjerë bimësh, duke përfshirë barëra dhe bimë gjethegjerë dhe drunore. Të ketë veprim relativisht të shpejtë. Koha e veprimit të herbicidit të jetë nga 1-3 javë pas trajtimit. Të ruaj efektin edhe nëse bie shi 1-2 orë pas spërkatjes. Koncetrat i tretshëm në ujë.

Subjektet pjesëmarrëse duhet të garantojnë cilësinë dhe efikasitetin e produktit të tyre. Herbicidi të ketë afat skadence jo më pak se 1 (një) vit nga data e dorëzimit, të shënuar në paketim.

Malli të jetë i shoqëruar me etiketë përkatëse të përdorimit të përkthyer në gjuhën shqipe.

Malli të jetë i ambalazhuar në bidona plastike 1 litërsh. Bidonat të jenë të rregullt të padëmtuar dhe të futur në kuti kartoni. Të jetë I ruajtur në ambalazh origjinal, në ambiente të thata e të freskëta, pa ndriçim, të ajrosura dhe të sigurta nga rreziku i zjarrit, në temp. 0°-35°C.

- PESTICIDTE (FUNGICID)

Lënda vepruese e pesticideve të ketë minimalisht 90% sqfur. Të jetë pluhur. Të ketë veprim relativisht të shpejtë dhe efektiv në largimin e gjarpërinjve. Malli të jetë i shoqëruar me etiketë përkatëse të përdorimit të përkthyer në gjuhën shqipe

Subjektet pjesëmarrëse duhet të garantojnë cilësinë dhe efikasitetin e produktit të tyre. Pesticidi të ketë afat skadence jo më pak se 1 (një) vit nga data e dorëzimit, të shënuar në paketim. Malli të jetë në paketim 1 kg. Paketimi të jetë i rregullt dhe i padëmtuar.

Herbicidet dhe pesticidet duhet të bëjnë pjesë në listen e PMB të regjistruara për t'u importuar dhe tregtuar në Republikën e Shqipërisë për perjudhën prill 2026.

Argumentim: Hartimi i specifikimeve teknike është bërë në bazë të pikës 3 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.88, datë 29.12.2016, “Për likuidimin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Funerale dhe krijimin e Agjencisë së Shërbimeve Funerale”, nenit 6 pika 2, nenit 44 pika 5, nenit 47 pika 4 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. Nr. 27381/1, datë 8.8.2022 “Për miratimin e Rregullores për Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Agjencisë së Shërbimeve Funerale, Institucion në Varësi të Bashkisë Tiranë”, nenit 6, pika 1 gërma “a”, pika 3 gërmat “a”, ”c” dhe “e”, pikat 4, 5 gërma “a” të ligjit nr.10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndëtin në punë”, i ndryshuar, të nenit 36, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Specifikimet teknike, grafiku i lëvrimin për mallrat objekt prokurimi, janë hartuar nga anëtarët e njësisë së prokurimit, të cilat janë bashkëlidhur me dokumentet e tenderit. Ato përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Specifikimet teknike janë hartuar në zbatim të urdhrit nr.35, datë 17.03.2026, protokolluar me nr.343/5, datë 17.03.2026, “Për ngritjen e njësisë së prokurimit për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje herbicide pesticide”. Anëtarët e Njesisë së Prokurimit, për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje herbicide pesticide”, që do të prokurohet për vitin 2026, kanë hartuar specifikimet teknike për herbicide dhe pesticide në bazë të pikës 3 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.88, datë 29.12.2016, “Për likuidimin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Funerale dhe krijimin e Agjencisë së Shërbimeve Funerale”; Nenit 6 pika 2, nenit 16 pika 5 “Punëtor varrezash”, nenit 17 pika 4 “Punëtor varrezash në Njësitë Administrative” të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. Nr. 27381/1, datë 8.8.2022 “Për miratimin e Rregullores për Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Agjencisë së Shërbimeve Funerale, Institucion në Varësi të Bashkisë Tiranë”; Pika 1 gërma “a”, pika 3 gërmat “a”, “c” dhe “e”, pika 4, pika 5 gërma “a” të ligjit nr.10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndëtin në punë”, i ndryshuar; Nenit 36, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Ato përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse të objektit që prokurohet, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Në specifikimet teknike të hartuara nuk është përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon mallrat e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP i ndryshuar. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Bazuar në specifikimet teknike të miratuara dhe hartuara nga Njesia e prokurimit e ngarkuar për këtë qëllim, Grupi i punës vendosi të bëjë studimin e tregut për secilin zë të shërbimeve të kërkuara, mbi bazën e të cilës përcaktohet fondi limit për procedurën e prokurimit. Pas identifikimit të subjekteve që operojnë në fushën e aktivitetit të objektit që prokurohet, kërkesa për përlllogaritjen e fondit limit me qëllim llogaritjen e vlerës së kontratës, ju dërgua 3 subjekteve, në përputhje me kërkesat teknike të përgatitura nga Njesia e prokurimit i ngritur me Urdhërin e sipercituar të Titullarit të Agjencisë së Shërbimeve Funerale.

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Grafiku i lëvrimit hartuar njësia e prokurimit është si më poshtë vijon:

Sasia e mallit që kërkohet:

Artikulli	Përshkrimi	Njesia	Sasia	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Herbicid (36% Glyphosat)	litër	1090	Magazinë	5 ditë kalendarike
2	Pesticid (90% Squfur)	kg	430	Magazinë	5 ditë kalendarike

Afatet e lëvrimit: Afati i lëvrimit është 5 ditë kalendarike duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës. Operatori ekonomik fitues do të kryejë furnizimin e mallit sipas grafikut të lëvrimit në magazinë.

Argumentim: Grafiku i lëvrimit për mallrat objekt prokurimi, është hartuar nga anëtarët e njësisë së prokurimit, të cilat janë bashkëlidhur me dokumentet e tenderit. Në grafikun e lëvrimit të mallit është pasur parasysh natyra, mënyra e ruajtjes dhe magazinimi i mallrave. Në përputhje me parashikimet e nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Shënim: Në zbatim të nenit 26 pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Shënim: Në mbështetje të nenit 88 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nëse kemi bashkim operatorësh ekonomikë, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje

me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

PËRLLOGARITJA E SIGURIMIT TË OFERTËS

Në mbështetje të nenit 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;”

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës për objektin e prokurimit është **28,480 (njezet e tete mije e katerqind e tetedhjetë leke)**. Afati i vlefshmërisë së ofertave është **150** (njëqind e pesëdhjetë ditë).

AFATET E ZHVILLIMIT TË PROCEDURËS

Neni 49 pika 3 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Afati për pranimin e ofertave në këtë procedurë prokurimi është jo më pak se 10 ditë nga publikimi i njoftimit të kontratës”.*

Fondi limi për procedurën e prokurimit është **1,424,000** (një milion e katërqind e njezet e katër mijë) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Tiranë, i cili ndodhet në kufirin e ulët monetar sipas parashikimeve të Vendimit Nr. 291, datë 15.5.2024 „Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik“.

Data për hedhjen e të dhënave në SPE u caktua data 29. 05. 2026. Shpallja e njoftimit të kontratës do të bëhet publike ditën e nesërme të punës nga dita e hedhjes së njoftimit në SPE, sipas parashikimeve të nenit 7 të V.K.M nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar. Data e shpalljes së njoftimit do të jetë 15. 06. 2026.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt: **“Blerje herbicide pesticide”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Anëtarët e Njesisë së Prokurimit